



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 110 dt.18.02.1994

MBI NDIHMEN EKONOMIKE QE PERFITOJNE FAMILJET
PER MUAJIN JANAR 1994.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.18.02.1994, pasi dëgjoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore, në zbatim të Ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993, V.K.M. Nr.328, dt.30.06.1993, V.K.M. Nr.495, dt.18.10.1993 dhe Udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale

VENDOSI

1. Të miratojë relacionin e paraqitur nga Seksioni i Ndihmës Ekonomike në zbatim të vendimeve të mësipërme në grup familje sipas numrit të anëtarëve.

1465 familje me 1 antarë
1208 familje me 2 antarë
2009 familje me 3 antarë
2316 familje me 4 antarë
719 familje me 5 antarë
230 familje me 6 antarë
72 familje me 7 antarë
87 familje mbi 7 antarë

Gjithsej 8106 familje.

2. Të përdoret hë për hë fondi i akorduar nga Ministria në masën 14 milion (i cili është 50% më i ulët se sa kërkesa nga ana e Seksionit për muajin Janar 1994). Ky fond të përdoret vetëm për masën e ndihmës pa futur këtu familjet me ndihmë të pjesshme dhe masën e kompesimit.
Kjo ndarje lekësh të bëhet për të mos krijuar konfrontime me njerëzit dhe pasi Këshilli Bashkiak të marrë në analizë Seksionin e Mbrojtjes Shoqërore për këtë problem, e ballafaquar kjo me Ministrinë dhe me verifikimet që po bëhen në vazhdimësi, nëse Këshilli Bashkiak e gjykon të arsyeshme të ndërhyjë pranë ministrisë përkatëse për shtesë fondesh.
3. Të përfitojnë ndihmë ekonomike familjet e mëposhtme si raste të veçanta :
 - Valbona Qirko, Nj.A.Nr.2
 - Mimoza Halit Pasha, Nj.A.Nr.11
 - Familjet që janë harruar nga administratorët për muajin Dhjetor (Nj.A.5, 106 familje, Nj.A.3, 18 familje, Nj.A.1, 2 familje).
4. Nuk përfitojnë ndihmë ekonomike familjet e poshtë shënuara :
 - Sokol Skënder Hoxha, Nj.A.Nr.5
 - Vladimir Feti Gjonaj, Nj.A.Nr.6
 - Durim Hilmi Kola, Nj.A.Nr.8
 - Lulzim Hilmi Kola, Nj.A.Nr.8
 - Bujar Besim Alimehmeti, Nj.A.Nr.8
 - Qazim Gjuzi, Nj.A.Nr.8, (për m. Nëntor 1993)
 - Zyber Tosku, Nj.A.Nr.7
5. Qytetarët (individ ose familje) që trajtohen me ndihmë ekonomike, në qoftëse nuk u tërhiqen lekët brenda afatit ligjor lekët arkëtohen dhe nuk kthehen më, biles familjet ose individë nuk do të trajtohen as për muajt e ardhshëm.

Këtu përjashtohen rastet kur kryefamiljari mund të ketë qenë shtruar në spital ose të kenë patur raste vdekjesh brenda në familje.

6. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen seksioni përkatës dhe administratorët shoqërorë, arkëtarët e njësive administrative.

KRYETARI

BESNIK PETRELA